



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr 16, date 26/01/2001

**“MBI KERKESAT DHE ANKESAT DREJTUAR KESHILLIT BASHKIAK TE
TIRANES PER DHENIET E LEJEVE TE NDERTIMIT NGA K.RR.T-ja”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës në mbledhjen e tij të dt.26.01.2001 pasi shqyrtoi relacionin “Mbi kërkesat dhe ankesat drejtuar Këshillit Bashkiak të Tiranës për dhëniet e lejeve të ndërtimit nga K.RR.T”, dhe propozimeve të komisionit ndërtimit dhe zhvillimit urban, bazuar në Ligjin 8405 dt.17.09.1998 “Për Urbanistikën”

V E N D O S I

1. Të mos priset ndërtimi i objektit 4 katësh, të rregullohet ambjenti përreth në Rr. “Gjin Bue Shpata” pronë të Z. V. Llagami, kjo në përgjigje të shkresës nr.prot. 7673 dt.23.10.2000 të Prefekturës Tiranë.
2. Të miratohet leja e ndërtimit për dyqan 1 kat në pronën e Z. Mërgim Kondi I cili merr përsipër prishje pa dëmshpërblim, kjo në përgjigje të shkresës me nr.prot. 7614, dt.19.10.2000 nga Prefektura e Tiranës.
3. Të miratohet leja e ndërtimit në Rr. “Hajdar Hidi” në pronë të F. Sinoymeri, kjo në përgjigje të shkresës me nr.prot. 58/15 nga Drejtoria e Administratës Publike pranë institucionit të Avokatit të Popullit.

4. Të mos shprehet përfundimisht, për lejen e ndërtimit nr.121 dt.28.07.2000 në Rr. “Mihal Grameno” sepse problemi është në proces qyjësor, kjo në përgjigje të shkresës me Nr.prot 8363, dt.21.11.2000 e ardhur nga Ministria e Punëve Publike.
5. Të mos shprehet për lejen e ndërtimit objekt 2 kat në Rr. “Siri Kodra” në pronë të Zj Fishku sepse problemi është në proces qyjësor, kjo në përgjigje të ankesës së bërë nga Haxhi Llanaj dhe Sabrie Fishku.
6. Të anulohet vendimi I K.RR.T në pronë të qytetarit Ismail Zhura, kjo në përgjigje të shkresës me nr.prot. 1824 dt.14.02.2000, e Njësisë Bashkiake Nr.4
7. Të miratohet (sepse nuk çënohet hapësira urbane midis pallateve) leja e ndërtimit të objektit 2 katësh në pronë të Z.Kadri Llanaj në Rr. “H Cenoymeri” kjo në përgjigje të shkresës nr.7685, dt.1.11.2000 nga Prefektura Tiranë.
8. Të plotësohet dokumentacioni (marrveshja me banoret) pastaj të rishqyrtohet në Këshillin Bashkiak, kjo në përgjigje të shkresës me nr.prot 8078, dt.09.11.2000 nga Prefektura Tiranë
9. Të anulohet leja e ndërtimit për objekt 5 kat me nr.538 dt.22.06.2000 në Rr. “M. Shyri” (përballë kinema Dajtit) në pronë të Z.Zyber Pepa, kjo në përgjigje të kërkesës me nr.321 dt.28.04.2000 nga banorët
- 10.Të rishqyrtohet në K.RR.T leja e ndërtimit me nr.226 dt.21.04.2000 e firmës “Glemar” (nuk respekton distancat, pa studim të miratuar), kjo në përgjigje të familjeve Dimroci dhe Vrapit me nr.prot.Xh-11, dt.07.12.2000
- 11.Të rishqyrtohet për anulim në K.RR.T leja e ndertimit me nr.592 dt.24.07.2000 në Rr. “Ferrit Xhajko”, në pronë të familjes Kallushi, kjo në përgjigje të banorëve të pall.59/6, 59/7, 59/3, 59/4
- 12.Të rishqyrtohet për anulim në K.RR.T leja nr.83 dt.22.01.2000, per objektin 3 kat në Rr. “Budi” në pronë të Jani Cekixhi, kjo në përgjigje të shkresës me nr.prot.8967, dt.18.12.2000, nga Prefektura Tiranë

13. Të rishikohen në K.RR.T leja e ndërtimit nr.719 dt.24.08.2000 në Rr. "Him Kolli" në pronë të Ilir Taflicës kjo në përgjigje të shkresës me nr.prot.138, dt.10.01.2001, nga Prefektura Tiranës.
14. Të anulohet leja e ndërtimit (nuk plotëson kondicionet) nr.654 dt.08.08.2000 në Rr. "Qamil Guranjaku" në pronë të familjes Cela, kjo në përgjigje të shkresës me nr.prot.7680, dt.23.10.2000 nga Prefektura Tiranës
15. Të rishqyrtohet në K.RR.T (nuk plotëson kondicionet) leja e ndërtimit nr.736 dt.29.08.2000 në Rr. "At ShtjefenGjecovi" në pronë të Elsona Agollit kjo në përgjigje të kërkesës me nr.prot.A-dt.20.12.2000 të Znj. Asije Hoxha
16. Të bllokohet shesh leje e ndërtimit nr.146 dt.17.02.2000 në Rr. Bulevardi "Zogu1" në pronë të familjes Kasoruho, kjo në përgjigje nr.prot.7851, dt.01.11.2000, nga Prefektura Tiranë
17. Të sqarohet baza ligjore, nga Drejtoria Juridike, Drejtoria Financës dhe Drejtoria e Urbanistikës për blerje trualli në Rr. "Myslym Shyri", në pronë shtetërore, pastaj t'i paraqitet Këshillit Bashkiak, kjo në përgjigje të shkresës me nr.prot.7818, dt.30.10.2000, nga SH.P.K "Eraldi"
18. Të rikthehet në K.RR.T (te respektohet distanca duke ulur numrin e kateve në pjesën lindore, duke krijuar një shkallëzim nga 8-të në 5-kate, për të realizuar distancën ligjore urbanistike) leja e ndërtimit nr.342 dt.28.04.2000 në Rr. "M. Gjollësja" në pronë të familjes Xhepa, kjo në përgjigje të shkresës me nr.prot.8079, dt.09.11.2000, nga Prefektura Tiranë

KRYETARI

Leonidha TOSKA

